



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"SHKËMBI" SHPK nga Istogu, të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 70362915 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

**NDERTIMI I RRUGËS LOKALE "ARIF HALILI" MUZHEVINE –
KOMUNA E ISTOGUT LOT 2**

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-18-7854-5-2-1/C 178 - LOT 2</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 018 / 069 / 521 – lot 2</i>

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**ND NDERTIMI I RRUGËS LOKALE "ARIF HALILI"
MUZHEVINE – KOMUNA E ISTOGUT LOT 2**

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit NDERTIMI I RRUGËS LOKALE "ARIF HALILI" MUZHEVINE – KOMUNA E ISTOGUT LOT 2 është: 13.980,00 dhe me fjalë Trembëdhjetë mijë e nëntë qind e tetëdhjetë euro €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veganta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbehet nga dokumentet në vijim:

Marëveshja e kontratës;
Kushtet e Veganta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyrjesi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbejnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësive ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:

Shpk "Shkëmbi"

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Musa Metaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	5.12.2018	Data:	05.12.18
Vu la		Vu la	